



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 22/08

Prishtinë, më 24 .09.2008, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj.

Anëtarët jo të pranishëm: Müfera Şinik, Kosara Nikolić, Behxhet Pacolli.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Hysni Hoxha, Tefik Sylejmani nga OSHP, monitruer nga Zyra e Presidencës, USAID, OSCE, NDI, KDI.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 04.09.2008;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për ndarjen e mjeteve për funksionimin e OSHP-së të datës 17.09.2008.
Të ftuar: Përfaqësues nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.**
- 4. Informata e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave lidhur me kërkesën e Komisionit për Buxhet dhe Financa të datës 10. 09.2008 për dorëzimin e pasqyrave të pagave për anëtarët e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 3312, dt.12.09.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për**

- emërimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;
6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/0952 /Do- 578, të datës 09.09.2008 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese;
 7. Shqyrtimi i Raportit të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyerjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 mbi Auditimin e Brendshëm, i shpallur me Rregulloren nr. 2007/19, datë 6 qershor 2007;
 8. Shqyrtimi i Projektligjit për Akreditimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente;
 9. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin plotësues të raportit dt.27.06.2008 të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente;
 10. Të ndryshme.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

Besa Gaxherri, bëri vërejtje për marrjen e vonshme të materialeve të caktuara për shqyrtim në këtë rend dite. Si rezultat i kësaj, theksoi se nuk ka mundur të përgatitet për diskutim. Kërkoi nga kryetari në këtë drejtim të jetë më i përpiktë dhe mbledhja së bashku me materiale të organizohet tre ditë përpara ashtu siç parashihet me Rregullores Punës së Kuvendit.

Safete Hadërgjonaj, gjithashtu u ankua për marrjen me vonesë të materialeve dhe për shkak të vëllimit të madh të tyre nuk ka mundur të përgatitet për në mbledhje.

Armend Zemaj, duke pasur parasysh faktin se materialet janë në vëllim të madh, propozoi që t'i diskutojnë ato që munden, ndërsa pikat tjera të shtyhen për në mbledhjen e radhës.

Haki Shatri, gjithashtu bëri vërejtje për marrjen me vonesë të materialeve, dhe për shkak të vëllimit të madh të tyre nuk ka mundur të i shikojë dhe përgatitet për në mbledhje. Kjo bie në ndesh edhe me Rregulloren e punës së Kuvendit, për shpërndarjen e materialeve tri ditë para mbledhjes. Për këto arsye z. Shatri braktisi mbledhjen.

Kryesuesi, duke i'u përgjigjur anëtarëve, theksoi se vonesat e organizimit të kësaj mbledhje kanë ndodhur edhe për faktin se stafit mbështetës i mungon një zyrtare dhe si rezultat i kësaj kanë qenë të ngarkuar me punë. Premtoi se në të ardhmen mbledhje do të organizohet në bazë të afatit të paraparë më Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Me vërejtjet e bëra, rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 4 shtator 2008

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 4 shtator 2008, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për ndarjen e mjeteve për funksionimin e OSHP-së të datës 17.09.2008.

Të ftuar: Përfaqësues nga Organi Shqyrtues i Prokurimit - Informata e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave lidhur me kërkesën e Komisionit për Buxhet dhe Financa dt. 2008 për dorëzimin e pasqyrave të pagave për anëtarët e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik

Kryesuesi, theksoi se pika e tretë dhe e katërt kanë të bëjnë më të njëjtën çështje. Informata e kërkuar nga MEF-i, janë bërë më qëllim që të merren informacione për pagat e dy Agjensioneve relevante, për të shërbyer si model për përcaktimin e pagave të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Lidhur me kërkesën OSHP-së, tha se ajo është plotësuar me detajet financiare. Prandaj kërkoi që të miratohet ajo sepse ky organ nuk po mundet të funksionojë edhe pse ka një numër të madhë çështjesh të parashtruar për t'u zgjidhur. Në vazhdim pyeti për pozitën zyrtar i lartë për trajtim të ankesave të paraparë në organogram, se a është menduar për një ekspert.

Hysni Hoxha, përkujtoj se OSHP-ja ka nisur punën më një gusht, por ka vështërsi në funksionim për shkak mos miratimit të buxhetit. Lidhur me pozitën e parapara në organogram i kanë reduktuar në minimumin e mundshëm. Njoftoi se kanë hequr nga kërkesa buxhetore kategorinë mëditje në shumën prej 5.000 € Kërkoi nga anëtarët ta mbështesin këtë kërkesë dhe t'u mundësohet funksionimi i lirshëm për të kryer lëndët e shumta që janë parashtruar para këtij organi e që janë të kushtëzuar me afat. Duke i'u përgjigjur pyetjes së kryetarit, personi në fjalë është paraparë në cilësinë e ekspertit, i cili do të trajtoj ankesat që parashtrohen para këtij organi që nga protokollimi i tyre e deri në vendimin përfundimtar.

Besa Gaxherri, duke pasur parasysh faktin se Kuvendi ka miratuar krijimin e këtij organi, kërkoi që të që komisioni të bëjë rekomandimin për miratimin buxheti të tyre në mënyrë që ai të jetë funksional.

Safete Hadërgjonaj, bëri vërejtje për numrin e madhë të punëtorëve të paraparë në organogram. Theksoi se është praktikë në institucionet e vogla buxhetore, që në kuadër të Drejtorisë së Administratës të hyjë zyrtari i personelit dhe zyrtari i buxhetit. Andaj nuk u pajtua që dy zyrtarët në fjalë të kenë pagat ashtu siq janë propozuar. Një pagë të tillë mund ta ketë një drejtor por që do t'i kryente si punët e personelit dhe po ashtu edhe të buxhetit. Kërkoi me rastin e bërjes së rekomandimit të shikohet ligji nëse ka bazë ligjore që kërkesa të përfshihet në linjat buxhetore pa kaluar në Kuvend.

Kryesuesi, duke i'u përgjigjur parafolës, theksoi se ka shikuar ligjin dhe ai nuk thotë se Kuvendi duhet doemos të miratojë, por kërkohet mendimi dhe pëlqimi i tij për të krijuar bazën ligjore. Prandaj kompetente është MEF-i, me të cilët ka biseduar dhe kanë thënë se janë pajtuar me këtë kërkesë dhe presin rekomandimin e Komisionit për të përfshirë në linjat buxhetore.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Miratohet kërkesa e Organit Shqyrtues të Prokurimit për ndarjen e mjeteve për funksionimin e OSHP-së të datës 17.09.2008 dhe i rekomandohet MEF-it që të njëjtin ta përfshij në linjat buxhetore të Buxhetit të përgjithshëm të Kosovës për vitin 2008.

4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 3312, dt. 12.09.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesuesi, duke komentuar kërkesën e TKPK-së, theksoi se pas ka lexuar ligjin ka vërejtur se nuk janë përfillur procedurat. Ligji thotë se duhet krijuar një komision për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të TKPK-së (citoi nenet e ligjit për TKPK-në), i cili i propozon Kuvendit kandidatët. Kuvendi më pas kërkon mendimin e Qeverisë para se t'i votojë. Ndërsa nga materiali që i'u është ofruar anëtarëve të komisionit shifet se është vetëm vendimi i Qeverisë dhe emrat e kandidatëve. Prandaj kërkoj që si komision të nxjerrin një përfundim për të kërkuar sqarime nga Qeveria për shmangien e procedurave dhe rregullatives ligjore për çështjen në fjalë.

Armend Zemaj, u pajtua që t'i bëhet një rekomandim Qeverisë për të dhënë sqarime për mosrespektim të procedurave për çështjen në fjalë.

Besa Gaxherri, kërkoj që Komisioni të bëjë interpretimin ligjor lidhur me rregullativën dhe procedurat ligjore për përzgjedhjen e këtyre kandidatëve, ndërsa ndaj Qeverisë të bëhet një ankesë për mosrespektim të procedurave ligjore. U shpreh kundër përfshirje së personave më shtetësi të huaj në këtë bord.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR , nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Propozimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës nuk është bërë në bazë të Ligjit nr. 03/L-48 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 të Fondit Pensional të Kosovës
 - II. Komisioni kërkon t'i dërgohet Kuvendit raporti i komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në pajtim me nenin 5.5, 5.6 dhe 11.5 të Ligjit nr.03/L-48 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 të Fondit Pensional të Kosovës.
- 5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/0952 /Do- 578, të datës 09.09.2008 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese**

Kryesuesi, lexoi kërkesën e TKPK-së për zbritjen e taksës menaxhuese që ka të bëjë më financimin e shpenzimeve të këtij fondi pensional. Kërkoj të deklarohen lidhur me këtë.

Hajdin Abazi, theksoi se vendimi i TKPK-së për zbritjen e taksës menaxhuese nuk duket i qartë, nuk tregohet se çka reflekton pozitivisht me një zbritje të tillë. Prandaj propozoi të shtyhet për në mbledhjen e radhë dhe të ftohen përfaqësuesit relevant për të dhënë sqarime.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR , nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni shqyrtoi kërkesën nr. 03/0952 /Do- 578, të datës 09.09.2008 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese dhe të njëjtën e shyte për shqyrtim dhe votim për në mbledhjen e radhës, në të cilën do të ftohen përfaqësuesit e TKPK-së për të dhënë

sqarime lidhur me vendimin në fjalë.

6. Shqyrtimi i Raportit të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyerjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 mbi Auditimin e Brendshëm, i shpallur me Rregulloren nr. 2007/19, datë 6 qershor 2007

Kryesuesi, njoftoi anëtarët për përgatitjen e raportit për monitorimin e Ligjit të auditimit të brendshëm, i cili është i përgatitur mirë dhe meriton të diskutohet në Kuvend. Për punë e bërë falënderoi grupin punues. Në vazhdim për shpjegime më të hollësishme kërkoi nga udhëheqësi i grupit punues, z. Zemaj të marrë fjalën.

Armend Zemaj, shpjegoi përmbajtjen e raporti dhe theksoi se si është përgatitur mirë. Prandaj kërkoi që Komisioni për të njëjtin të rekomandoj për debat në seancën plenare. Për punën në hartimin e këtij raporti kontribut të madhë kanë dhënë përfaqësuesi e NDI z. Shefki Kastrati dhe zyrtarin mbështetës të komisionit, z. Vilson Ukaj, të cilët edhe i falënderoi.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se kemi harmonizuar amendamentet si grup punues. Gjatë punës në teren kemi vërejtur mjaftë parregullsi të zbatimit të ligjit në fjalë. Problem për ndërmarrjet publike paraqet Ligji për ndërmarrjet i cili përjashton auditimin sipas ligjit të auditimit. Përmendi edhe rastin e KEK-ut dhe kërkoi që Komisioni të vendos për rekomandimin e krijimit të një komisioni hetimor.

Besa Gaxherri, si anëtare e grupit punues falënderoi udhëheqësin e këtij grupi si dhe stafin mbështetës që kanë bërë një punë të mirë. Nga raporti shifet se sa e rëndësishme është të bëhet monitorimi i ligjeve, e të cilat nga praktika shifet se pak imlementohen. Prandaj Komisioni duhet të mbështet atë për kalim për debat në Kuvend. Raport i tillë të jetë shembull për monitorimin e ligjeve, e që është edhe njëra ndër detyrat e komisioneve parlamentare.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Miratohet Raportit të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyerjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 mbi Auditimin e Brendshëm, i shpallur me Rregulloren nr. 2007/19, datë 6 qershor dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit ta radhis në rend dite për diskutim në seancën plenare.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Akreditimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, theksoi se Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe si të tillë kërkoi që ta miratojnë.

Pas që nuk kishte vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjit për Akreditimin dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.

II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamentet e Komisionit Funkcional – Komisionit për Ekonomi, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion me amendamente dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin plotësues të raportit dt.27.06.2008 të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, theksoi se Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore, por duke pasur parasysh faktin se tri herë diskutohet në komision, kërkoi nga anëtarja e komisionit funksional shpjegime për plotësimet dhe ndryshimet që janë bërë.

Safete Hadërgjonaj, njoftoi se arsyeja pse është zgjatur ky raport ka të bëjë me atë se është ndërhyrë nga stafi mbështetës pa lejen e grupit punues. Raport i prezantuar tani është plotësuar dhe si i tillë për nga ana përmbajtësore është i gatshëm për miratim. Por megjithatë duhet përmisuar referencat, të cilat edhe pse është kërkuar të përmisohet, ato nuk janë bërë. Prandaj kërkoi që Njësia për Harmonizim dhe Standardizim ligjor të përmisoj këto referenca.

Haxhi Gashi, mbështeti znj. Hadërgjonaj, se referencat duhet ndryshuar. Sugjeroi që Komisioni të jep një rekomandim për miratimin e tij dhe një vërejtje për rregullimin e referencave sepse ashtu siç është paraqet vështërsi në zbatimin e ligjit.

Xhevdet Neziraj, duke u ndërlidhur me çështjen në fjalë, theksoi se është dashur që këto referenca të rregullohen në komisionin funksional.

Shkumbin Demaliaj, kërkoi që të miratohet raporti dhe më pas Njësia për harmonizim dhe standardizim së bashku me stafin të rregullojnë problemin e referencave. Kërkoi që mos të ndërhyhet në çështjet përmbajtësore të raportit sepse është kompetencë e komisionit funksional.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjit ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin plotësues të raportit dt.27.06.2008 të komisionit funksional dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.

II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamentet e Komisionit Funkcional – Komisionit për Ekonomi, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion me amendamente dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Vërejtje konkrete:

Komisioni kërkon nga Njësia për standardizim dhe harmonizim ligjor të rregulloj referencat e projektligjit në bazë të teknikës së hartimit të amendamenteve.

9. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi për plotësimin e kërkesës së Ministrisë së FSK-së lidhur me buxhetin e tyre më të dhëna të detalizuara financiare, ashtu siq është kërkuar nga Komisioni.

Safete Hadërgjonaj, kërkoi të mbështet kërkesa pasi që është plotësuar me detaje. Të nxjerret rekomandim në mënyrë që të kalojë në Kuvend në seancën e së nesërme.

Besa Gaxherri, u shpreh kundër mënyrës së shqyrtimit të kërkesave që vijnë për procedim nga Qeveria duke u konsideruar si urgjente. Edhe pse përkrahu kërkesën, tha se duhet respektohen procedurat dhe ligjet.

Armend Zemaj, kërkoi që të miratohet sepse shumat janë të parapara. Janë rregullat financiare që rregullojnë atë.

Shkumbin Demaliaj, edhe pse më urgjentë, pasi që është plotësuar, theksoi se e mbështet kërkesën për FSK-në për shkak të mbështetjes së madhe që duhet dhënë kësaj ministrie.

Hajdin Abazi, pasi që kërkesa është mjaftë e detalizuar kërkoi që të mbështet ajo. Gjithashtu u pajtua që të bëhen vërejtje ekzekutivit të respektoj afatet procedurale ligjore me rastin e parashtrimit të kërkesave të këtilla.

Kryesuesi, u pajtua me vërejtjet për mosrespektim të procedurave ligjore. Por pasi që kërkesa në fjalë është plotësuar kërkoi që të mbështet dhe premtoi vërejtjet e bëra do t'i përcjellën Qeverisë dhe Ministrive që në të ardhmen të respektojnë procedurat dhe afatet ligjore.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Miratohet kërkesa nr. 06/2008 e Ministrisë së Forcës së Sigurisë për miratimin e Planit Buxhetor për periudhën shtator-dhjetor 2008 dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit ta radhis për shqyrtim në rend dite në seancën plenare të radhës.

Kryesuesi, njoftoi për kërkesat buxhetore të disa organizatave buxhetore për vitin 2009, materialet e te cilëve i keni marrë, kërkoi që të analizohen dhe në mbledhjet e ardhshme do të shqyrtohen ato.

Safete Hadërgjonaj, bëri vërejtje për mospërfilljen e Komisionit gjatë përgatitjes së planifikimit të buxhetit të Kuvendit për vitin 2009, e që tregon edhe një rast të shkeljes të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Armend Zemaj, njoftoi se grupi punues së bashku me ndihmën e ekspertëve të USAID-it, kanë përgatitur amendamentet lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe se në mbledhjen e radhës të Komisionit do të prezantohen për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Kryesuesi i Komisionit

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Gani KOCI